



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Kolegjit Universitar
“Wisdom”
Qershor 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|----------------------|---------|
| 1 | Z. Grant Horsburgh | Kryetar |
| 2 | Prof. Juliana Latifi | Anëtare |
| 3 | Z. Kevin Kendall | Anëtar |

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Rreth këtij vlerësimi.....	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raport i përmbledhur	6
Përmbledhje e gjetjeve.....	9
Raporti i detajuar.....	11
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	11
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	15
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	20
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	25
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	29
Lista e dokumenteve	32

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Universitar “Wisdom” është një institucion jopublik i arsimit të lartë, që ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fusha të tilla, si: drejtësi dhe shkencë ekonomike dhe shoqërore. “Wisdom” e mori statusin universitetit në vitin 2008 me Vendim të Këshillit të Ministrave, por ishte i licensuar që prej vitit 2006.

Gjatë kohës së kryerjes së këtij vlerësimi, universiteti përbëhej nga dy fakultete kryesore, të cilat ndaheshin në katër departamente: Fakulteti i Drejtësisë, që përbëhej nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe Departamenti i së Drejtës Private; dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, që përbëhej nga Departamenti i Psikologjisë dhe Departamenti i Ekonomisë. Krahas kësaj, secili prej fakulteteve ka Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ndërsa i gjithë universiteti ka gjithsej 10 njësi administrative. Në universitet punojnë 42 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë dhe katër me kohë të pjesshme, si dhe ofrohen katër programe studimi të ciklit të parë (Bachelor) dhe tre programe studimi të ciklit të dytë (Master i Shkencave). Në programet e nivelit Bachelor të universitetit janë regjistruar 261 studentë, ndërsa në programet e Masterit të Shkencave 141. [**Informacion për IAL-në faqen e APAAL-it**]

Raport i përmbledhur

Kolegji Universitar "Wisdom" është një institucion jopublik i arsimit të lartë, i cili ka filluar ta ushtrojë veprimtarinë me statusin e tij aktuale që prej vitit 2008. Gjatë kohë së kryerjes së këtij vlerësimi, universiteti kishte afërsisht 400 studentë, si dhe ofronte katër programe studimi të ciklit të parë (Bachelor) dhe tre të ciklit të dytë (Master i Shkencave). Stafi akademik mësimdhënës i universitetit përbëhet nga 10 anëtarë me kohë të plotë dhe një me kohë të pjesshme, të cilët japin mësim në dy fakultetet: Fakulteti i Drejtësisë, që përbëhet nga Departamenti i së Drejtës Publike dhe Departamenti i së Drejtës Private; dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, që përbëhet nga Departamenti i Psikologjisë dhe Departamenti i Ekonomisë.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u përpilua nga grupi i ngritur nga universiteti, që përfshinte stafin drejtues, stafin akademik dhe personelin mbështetës, si dhe një përfaqësues të studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë përpara përfundimit dhe miratimit nga Rektorati dhe Senati Akademik.

Vizita u realizua gjatë dy ditëve, në datat 15 dhe 16 qershor të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e personelit të institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështetet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, të jetë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë, përpara dhe gjatë vizitës. Larmia e informacionit mbështetës, e siguruar nga universiteti, mundësoi njohjen e grupit me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e veprimtarisë mësimdhënëse dhe kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe rregulloret e universitetit, raportin vjetor të ministrisë, raportet e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e mënyrave të informimit rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, Grupin e Vetëvlerësimit, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët e jashtëm dhe alumni. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të kampusi kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët, ambientet sportive dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandoi universitetit shqyrtimin e mënyrave për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe përmirësimin e

mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve të tij. Grupi i vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, që iu ofron studentëve dhe personelit mundësi për mobilitet, si dobësi, dhe si rrjedhojë i rekomandon universitetit vijimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, si një mënyrë për nxitjen e mundësive për mobilitet, si për personelin, ashtu edhe studentët. (**Kapitulli III, Standardi III.4**).

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i dha universitetit tre rekomandime, të cilat duhet të merren parasysh për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve të tij. Ai e konsideron mungesën e një sistemi të koordinuar informacioni të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) si dobësi, dhe i rekomandoi universitetit identifikimin dhe instalimin e softuerit të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në të dhënat personale dhe në burimet e posaçme të mësimdhënies dhe mësimnxënies për çdo program studimi që ofrohet (**Kapitulli III, Standardi VII.1**). Edhe infrastruktura e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara identifikohet si dobësi, dhe rrjedhimisht Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon universitetit hartimin dhe zbatimin e një plani të caktuar për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara në të gjitha ambientet e mësimdhënies dhe mësimnxënies (**Kapitulli I Standardi VI.3**). Mungesa e librave në format të shtypur konsiderohet sërish si dobësi, dhe universitetit i rekomandohet rishikimi i të gjithë stokut të librave në format të shtypur të bibliotekës, për sigurimin e përmbushjes së nevojave të mësimdhënies dhe mësimnxënies së studentëve dhe personelit. (**Kapitulli III Standardi V.2**).

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Megjithatë, ai i rekomandoi universitetit shqyrtimin e mënyrave për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve të tij. Mungesa e sugjerimeve të palëve të jashtme të interesit për zhvillimin e kurrikulës identifikohet si dobësi, dhe rekomandohet shqyrtimi i mënyrave për lehtësimin e dhënies së sugjerimeve nga ana e palëve të jashtme të interesit për zhvillimin e kurrikulës, me qëllim ofrimin e më shumë mundësive të punësimit për studentët. (**Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.12**).

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i dha universitetit tre rekomandime, të cilat duhet të merren parasysh për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve të tij. Mungesa e një strategjie zyrtare kërkimore për përcaktimin e prioriteteve kërkimore në shkallë institucioni dhe departamenti konsiderohet si dobësi, dhe si rrjedhojë, universitetit i rekomandohet hartimi dhe zbatimi

i një strategjie zyrtare kërkimore për përcaktimin e prioriteteve kërkimore në shkallë institucioni dhe departamenti. (**Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5**). Edhe mungesa e prioriteteve, analizave dhe diskutimeve specifike kërkimore brenda departamenteve identifikohet si dobësi, dhe si rrjedhojë, universitetit i rekomandohet sigurimi i marrjes përsipër të përgjegjësisë nga ana e departamenteve, për nxitjen, koordinimin dhe drejtimin e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore të ngritura. (**Kapitulli II Standardi I.1**). Mungesa e veprimtarisë kërkimore në bashkëpunim me partnerë dhe mosangazhimi në projekte evropiane në fushën kërkimore shkencore konsiderohet sërish si dobësi, dhe si rrjedhojë, universitetit i rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një plani të përcaktuar për sigurimin e zhvillimit të një axhende ndërkombëtarizimi, në qendër të së cilës të vendosen kryesisht angazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimi me institucionet e huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi (**Kapitulli II Standardi I.3**).

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Strukturat institucionale për orientimin e studentëve dhe punën mbështetëse funksionojnë në përputhje me Statutin dhe rregulloret. Universiteti ndjek politika dhe procese të përshtatshme mbështetëse, që i ndihmojnë studentët në gjetjen e vendeve të punës.

Kolegji Universitar "Wisdom" e ndërmori vlerësimin në përputhje e udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerësoi shkallën e angazhimit të universitetit në këtë proces dhe bashkëpunimin që tregoi gjatë fazës së vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, që iu ofron studentëve dhe personelit mundësi për mobilitet (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- mungesa e një sistemi informacioni të koordinuar dhe të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- infrastruktura e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara (pika 2.9; **Kapitulli I Standardi VI.3**)
- mungesa e librave në format të shtypur në bibliotekë (pika 2.11; **Kapitulli II Standardi V.1**)
- mungesa e sugjerimeve formale të palëve të jashtme interesit për zhvillimin e kurrikulës (pika 3.9; **Kapitulli I, Standardi I.7; Kapitulli I, Standardi I.12**).
- mungesa e një strategjie zyrtare kërkimore për përcaktimin e prioriteteve, në shkallë institucioni dhe departamenti (pika 4.5; **Kapitulli II, Standardi I.4; Kapitulli II, Standardi I.5**).
- mungesa e prioriteteve, analizave dhe diskutimeve specifike kërkimore brenda departamenteve (pika 4.6; **Kapitulli II, Standardi I.1**)
- mungesa e veprimtarisë kërkimore në bashkëpunim me partnerë, dhe mosangazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- vijimi i bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si një mënyrë për nxitjen e mundësive për mobilitet, si për personelin, ashtu edhe për studentët (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- identifikimi dhe instalimi i softuerit të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në të dhënat personale dhe në burimet e posaçme të mësimdhënies dhe mësimnxënies për çdo program studimi që ofrohet (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- hartimi dhe zbatimi i një plani të caktuar, si çështje urgjente, për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimdhënies dhe mësimnxënies (pika 2.9; **Kapitulli I Standardi VI.3**)
- rishikimi i të gjithë stokut të librave në format të shtypur të bibliotekës, si çështje urgjente, për sigurimin e përmbushjes së nevojave të mësimdhënies dhe

mësimnxënies së studentëve dhe personelit (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi V.1**)

- shqyrtimi i mënyrave, si çështje urgjente, për lehtësimin e dhënies së sugjerimeve të palëve të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të kurrikulës, për ofrimin e më shumë mundësive për punësim (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.12**)
- hartimi dhe zbatimi i një strategjie zyrtare kërkimore, si çështje urgjente, për përcaktimin e prioriteteve kërkimore në shkallë institucioni dhe departamenti (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5**)
- sigurimi i marrjes përsipër të përgjegjësisë nga ana e departamenteve, si çështje urgjente, për nxitjen, koordinimin dhe drejtimin e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore të ngritura (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- hartimi dhe zbatimi i një plani të përcaktuar për sigurimin e zhvillimit të një axhende ndërkombëtarizimi, në qendër të së cilës të vendoset kryesisht angazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimi me institucionet e huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Kolegjin Universitar “Wisdom”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Kuadrot drejtues dhe rregullatorë të universitetit janë hartuar në pajtim me kërkesat shtetërore ligjore për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV fq.6]** Misioni, organizimi i brendshëm dhe strukturat drejtuese të universitetit përcaktohen në Statutin e Universitetit, **[A1]** ndërsa në rregulloret e tij përcaktohen përgjegjësitë specifike dhe të përgjithshme të bordit dhe këshillit. **[A10]** Kolegji i amendon dhe i ndryshon Statutin dhe rregulloret e tij sipas nevojave. **[B3-B5]** Për të siguruar përputhshmërinë me ligjin e ri për arsimin e lartë dhe me ndryshimin e statusit në kolegji universitar, është hartuar Statuti i rishikuar, i cili, aktualisht, i është dërguar ministrisë për miratim. **[M3-M5]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Institucioni është organizuar në mënyrë të tillë, që të sigurojë efikasitet në drejtim, në përputhje me kërkesat e ministrisë. **[RVV fq.6-8; A1; A10]** Qarkullimi i informacionit nga departamentet te Senati, si dhe informimi i personelit dhe studentëve rreth vendimeve të Senatit janë të efektshme. Marrëveshjet për drejtimin dhe administrimin e institucionit, si dhe për vendimmarrjen kolegjiale marrin parasysh kërkesat ligjore, funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe kuptohen nga personeli i të gjitha niveleve. **[RVV fq.6-8; M2-M5; M10; M11]** **[Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Bordet dhe këshillat mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e axhendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë personelit në mënyrë elektronike. **[RVV fq.8; B2-B5; M2-M5; M10; M11]** Si bordet dhe komisionet e ngritura formalisht, ashtu edhe proceset dhe procedurat e brendshme janë në vitin e tyre parë të funksionimit, dhe duhet të monitorohen dhe të vlerësohen, për të vlerësuar efikasitetin e tyre. **[M4; M5; M11]** Megjithatë, studentët dhe personeli u shprehën se çështjet e ngritura prej tyre shqyrtohen përmes debateve konstruktive nga bordet dhe këshillat. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe ato për mbështetjen e diskutimeve dhe debateve kolegjiale kuptohen nga personeli dhe studentët. **[M2-M6; M10; M11]** Përgjegjës për monitorimin në shkallë fakulteti dhe departamenti të zbatimit të vendimeve të bordeve dhe këshillave të institucionit janë dekanët dhe përgjegjës të departamenteve. **[M2-M5; M10; M11]** **[Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.4 Institucioni siguron respektimin e kufijve të autonomisë së tij dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij brenda kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. **[RVV fq.9-10]** Vetëdrejtimi dallohet qartë në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë mësimdhënëse dhe shkencore, si dhe në çështjet financiare dhe administrative. **[A11-A19; B2-B5; M2-M5; M10; M11]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i raporton Senatit dhe gëzon autonomi operacionale në mbikëqyrjen e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm. **[RVV fq.9; A16; A17; A19; M3-M5; M11]** Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, së bashku me një organizatë partnere, ka aplikuar

për financim në Erasmus+, si dhe ka angazhuar ekspertë të jashtëm për mbështetjen e veprimtarive institucionale. Disa prej shembujve përfshijnë mbajtjen e leksioneve rreth së Drejtës Evropiane nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, ofrimin e trajnimeve rreth aftësive kërkimore praktike nga arkivistët qeveritarë, dhe dhënien e sugjerimeve për ndryshimin e kurrikulës nga avokatët praktikantë, për sigurimin e përditësimit të saj.[RVV fq.10; A38; A41-A43; M3-M5; M11][*Kapitulli III Standardi I.4*]

- 1.5 Institucioni ka një Strategji të përshtatshme Zhvillimi për periudhën 2016-2020, e cila është miratuar nga Senati.[RVV fq.10; A18; C7] Ajo është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, si dhe i është nënshtruar shqyrtimeve nga organet drejtuese dhe këshillat në faza të ndryshme të hartimit.[RVV fq.10; B2-B5; M3; M4; M11] [*Kapitulli III Standardi I.5*]
- 1.6 Në raportin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përshkruhen programet e mësimdhënies dhe studimit, kërkimi shkencor, personeli, angazhimi në projekte, si dhe çështjet ekonomike dhe financiare.[RVV fq. p.10-11; B12] Procesi i hartimit është mbështetur në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe të Vetëvlerësimit për veprimtarinë e departamentit dhe të programit të studimit. Raporti përfundimtar miratohet nga Senati gjatë një mbledhjeje të hapur për të gjithë personelin dhe studentët. [RVV fq.11; M3; M4; M6; M11] [*Kapitulli III Standardi I.6*]
- 1.7 Fakultetet dhe departamentet janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Anëtarët e stafit akademik kanë kualifikimet e duhura, ku shtatë nga dhjetë gjithsej janë kualifikuar në nivel doktrate, dhe gëzojnë autonomi dhe liri akademike gjatë mësimdhënies, kërkimit dhe të gjitha veprimtarive të tjera akademike. Universiteti ka një faqe zyrtare interneti dhe ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë.[RVV fq.11-12; B11; informacion për IAL-në në faqen e APAAL-it]; M2-M4; M10; M11] [*Kapitulli III Standardi II.1*]
- 1.8 Universiteti ka rrjetin e tij të partnerëve në rang kombëtar dhe rajonal, ku përfshihen institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe biznese.[RVV fq.11-13; A41-A43; AE46] Stafi akademik, alumni dhe ofruesit e praktikave profesionale u shprehën se midis organizatave vendore dhe rajonale, dhe departamenteve dhe programeve janë krijuar lidhje të forta. Stafi akademik bashkëpunon ngushtësisht me këto organizata për t'i ofruar studentëve mundësi për zhvillimin e praktikës dhe mundësi punësimi, si dhe për të siguruar përditësimin e kurrikulës. Kjo gjë dhe studimi i tregut i ndërmarrë në shkallë institucioni, mundëson informimin e përshtatshëm të fakulteteve, departamenteve dhe programeve rreth mundësive të zhvillimit ekonomik rajonal. Studimet më të fundit të tregut janë përqendruar në kërkesën e mundshme në të ardhmen për menaxherë marketingu të kualifikuar, si dhe avokatë e psikologë, kryesisht në sektorin publik. Institucioni e përdor këtë informacion, për t'iu përcjellë studentëve aftësitë e nevojshme për punësim në këto sektorë.[RVV fq.12-13;

A25-A27; B14; M3; M4; M6; M10 M11][Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli III Standardi III.2]

- 1.9 Lidhja e marrëveshjeve me partnerët e huaj mbikëqyret nga Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ndërsa bashkëpunimet vendore dhe rajonale mbikëqyren nga departamentet .[RVV fq.13-14; A35; A38; M4; M11] Gjithashtu, bashkëpunimet me organizatat e tjera për caktimin e studentëve në praktika profesionale administrohen në shkallë departamenti.[**Kapitulli III Standardi III.3**]
- 1.10 Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh zyrtare, që mundësojnë pjesëmarrjen e personelit dhe studentëve në veprimtari ndërkombëtare si: në Austri, Kretë, Greqi, Itali, Kosovë dhe Maqedoni.[RVV fq.15-16; A35; A38] Pavarësisht lidhjes së marrëveshjeve, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe shfrytëzimi i mundësive për mobilitet nga personeli dhe studentët është i ulët, gjë që konsiderohet nga personeli me përvojë si një fushë që ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. [RVV fq.16; M2-M5] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi mungesën e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, që i ofron personelit dhe studentëve mundësi për mobilitet si **dobësi**, dhe si rrjedhojë i **rekomandon** universitetit vijimin e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, si një mënyrë për nxitjen e mundësive për mobilitet, si për personelin, ashtu edhe për studentët. Shihni edhe pikën 3.6.[**Kapitulli III Standardi III.4**]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, që iu ofron studentëve dhe personelit mundësi për mobilitet (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- vijimi i bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë si një mënyrë për nxitjen e mundësive për mobilitet, si për personelin, ashtu edhe për studentët (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi III.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Struktura e institucionit përshkruhet qartësisht në Statut dhe në rregullore, ndërsa organigrama është e publikuar në faqen e internetit, në të cilën bëhet dallimi ndërmjet fushave akademike dhe administrative. **[RVV fq.17-18; A1; A10; A49; B9;** http://www.wisdom.edu.al/pdf/Kolegji_Universitar_Wisdom_Organigrama.pdf]. Rekrutimi i anëtarëve të stafit akademik bëhet sipas meritës dhe kriterëve specifikë të kërkuara. **[RVV fq.17-18; A45; M4; M10]** Procesi i rekrutimit, duke përfshirë edhe identifikimin e nevojave, njoftimin, përzgjedhjen dhe marrjen në intervistë të kandidatëve, dhe procedurat shoqëruese administrative drejtohet nga Politika e Rekrutimit të Stafit Akademik. **[A45; B15]** I gjithi ky proces menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës Studentore, që mbulojnë të gjitha çështjet e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe ruajtjen e dokumentacionit dhe dosjeve personale të personelit. **[RVV fq.17; A55; A56]** Gjatë mbledhjeve me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, personeli tregoi se i njihte mirë këto procese. **[M4; M10]** Gjithashtu, personeli u shpreh se vendet e lira të punës shpallehin në faqen e internetit. [\[http://www.wisdom.edu.al/post/njoftim-nga-zyra-e-burimeve-njerezore\]](http://www.wisdom.edu.al/post/njoftim-nga-zyra-e-burimeve-njerezore) Megjithatë, në këtë faqe publikohet vetëm emërtimi i pozicionit të punës, pa ofruar hollësi të mëtejshme, dhe personave të interesuar iu kërkohet të kontaktojnë institucionin për më shumë informacion. **[Kapitulli III Standardi IV.1; Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.2 Lista e anëtarëve të stafit akademik tregon se pedagogët e të gjithë fakulteteve dhe departamenteve janë plotësisht të kualifikuar. **[A47]** Numri i anëtarëve të stafit akademik me kohë të plotë është 42, i anëtarëve me kohë të pjesshme është katër, ndërsa i anëtarëve të personelit administrativ është 19, dhe që të gjithë janë me shtetësi shqiptare. **[RVV fq.18; Informacion për IAL-në në faqen e APAAL-it]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi dy prej anëtarëve të stafit akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë rekrutuar falë kualifikimeve që zotërojnë. **[M10]** Megjithatë, gjatë mbledhjeve u vërejt se, pavarësisht pohimit të institucionit se i jepej përparësi atyre që ishin diplomuar në universitetet Perëndimore dhe zotëronin gjuhë të huaja, shumë pak anëtarë të stafit akademik kishin përvojë pune në gjuhën angleze. **[RVV fq.17; M2-M5; M10; M11]** Stafi akademik emërohet nga Dekani përkatës, ndërsa kontrata e punës nënshkruhet nga Administratori dhe punëmarrësi. **[A48]** Dosja e plotë e statistikave të punësimit mbahet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës Studentore. **[A51]** **[Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Integrimi i stafit akademik dhe personelit administrativ realizohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive të përbashkëta nga institucioni, si p.sh i seminareve, konferencave, veprimtarive promovuese, vizitave në shkollat e mesme dhe aktiviteteve sociale, të cilat u pohuan nga personeli gjatë mbledhjes. **[RVV fq.18; M10]** Për t'i informuar personelin dhe studentët rreth veprimtarive më të rëndësishme të viteve të fundit, është publikuar një kalendar, ku tregohet larmia

e veprimtarive akademike në mbështetje të integritimit. **[A50] [Kapitulli III Standardi IV.2]**

- 2.4 Instituti e ndjek politikën për vlerësimin periodik të aftësive të personelit në përputhje me Statutin dhe rregulloret. **[RVV fq.18-19; A1; A10; B16]** Vlerësimi i personelit bazohet në rezultatet e pyetësorëve të studentëve në fund të çdo semestri; raportet e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që mbështeten te Raportet e Vetëvlerësimit, kontrollet e orëve të mësimit dhe vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit. Të gjitha këto, përgjegjësi i departamentit i diskuton me pedagogun përkatës në fund të vitit. **[RVV fq.18-19; B16; M3; M6; M10]** Pritet që, edhe gjatë periudhës së caktuar për veprimtari jomësimdhënëse në planin vjetor, stafi të përditësohet lidhur me lëndën që jep mësim. **[M4; M10]** Institucioni krijon dhe ruan një dosje për veprimtaritë e vlerësimit të çdo anëtari stafi, e cila merret parasysh për përmirësimin e mangësive dhe marrjen e vendimeve lidhur me ngritjen në detyrë. **[A56-A58; M3; M6; M10][Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.5 Përmasat e vogla të institucionit, me vetëm 65 anëtarë personeli dhe 400 studentë, ndihmojnë në nxitjen e marrëdhënieve të ngushta midis studentëve dhe personelit. **[RVV fq.19; M2-M6; M10; M11]** Për lehtësimin dhe mundësimin e kësaj marrëdhënieje organizohen veprimtari, si darka apo dreka në raste festash, ditëlindjesh apo aktiviteteve promovuese. Universiteti ofron sigurime shëndetësore dhe shoqërore, sipas kërkesave. **[RVV fq.19; M2-M6; M10; M11; A52] [Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.6 Meqenëse “Wisdom” është institucion jopublik i vetëfinancuar; të ardhurat përfitohen nga tarifat e shkollimit të studentëve. **[RVV fq.20; A1]** Kancelari është punonjësi më i lartë administrativ, i cili është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë financiare dhe administrative të institucionit. **[RVV fq.20; B17; M11]** Propozimet për vitin e ardhshëm paraqiten fillimisht nga departamentet, të cilat më pas mblidhen në shkallë fakulteti, ndërsa buxheti i përgjithshëm institucional hartohet nga Kancelari. Ky i fundit diskutohet në Rektorat përpara miratimit përfundimtar nga Bordi i Administrimit. **[RVV fq.20; M11]** Personeli u shpreh se financat nuk ishin faktor kufizues, dhe se atyre iu ofroheshin të gjitha burimet që kërkonin. **[M10]** Megjithatë, Kancelari e monitoron rregullisht buxhetin e miratuar dhe nuk e lejon shpërdorimin e tij nga ana e departamenteve. **[M11]** Ai mbështetet nga Zyra e Financës, e cila mban të dhënat e të gjitha transaksioneve financiare. **[A58; A59]** Pasqyrat financiare duhet të miratohen nga ministria, por nuk i nënshtrohen auditimit të pavarur dhe nuk publikohen. **[M11]** Menaxhimi financiar kryhet në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat statutores dhe ligjore. **[RVV fq.20-22] [Kapitulli III Standardi VI.1; Kapitulli III Standardi VI.2; Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.7 Institucioni ka një faqe zyrtare ku ofron informacion të hollësishëm rreth strukturës, procedurave dhe veprimtarive, si dhe përmbledhje të shkurtra të programeve të ofruara. **[RVV fq.22; <http://www.wisdom.edu.al>]** Stafi mësimdhënës përdor si mjet komunikimi me studentët emaili, për të cilin

studentët u shprehën se ishte diçka e pranueshme. [M6; M10] Megjithatë, nuk ka asnjë sistem informacioni të koordinuar dhe të mbrojtur me fjalëkalim personal, me anët të të cilit studentëve dhe personelit t'iu ofrohet akses në informacione konfidenciale, si p.sh në burimet e posaçme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, apo në notat e studentëve. [M6; M10; M11] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e sistemit të informacionit të koordinuar dhe të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) si **dobësi**, dhe si rrjedhojë, i **rekomandon** universitetit identifikimin dhe instalimin e softuerit të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në të dhënat personale dhe në burimet e posaçme të mësimdhënies dhe mësimnxënies të çdo programi përkatës [Kapitulli III Standardi VII.1]

2.8 Kërkesat e hapësirës për personelin dhe studentët përputhen plotësisht me standardet e vendosura nga ligji i ri për arsimin e lartë. [RVV fq.23-25; A66; Turi te burimet e mësimnxënies] Në vitin 2015, institucioni autorizoi hartimin e një raporti teknik për godinat, i cili duket se nuk ka nxjerrë në pah asnjë problematikë për të cilin institucioni duhet të veprojë. [C8] Infrastruktura përbëhet nga tre godina, dy prej të cilave ndodhen në kampusin kryesor, ndërsa tjetri pak më larg. Kampusi kryesor përbëhet nga godina administrative dhe një godinë tjetër më e madhe, ku zhvillohen veprimtaritë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. [Turi te burimet e mësimnxënies] Godina kryesore ka 15 auditorë, një sallë konferencash, një sallë informatike, një bibliotekë të vogël dhe një sërë zyrash. Gjithashtu, aty ndodhet një kafene dhe një hapësirë e përbashkët për personelin dhe studentët. [Turi te burimet e mësimnxënies] Për përdorimin e ambienteve sportive, institucioni kontraktonte organizata të tjera, gjë për të cilën studentët u shprehën se funksionon mirë. [A115; M6] Në sallën e informatikës ka 12 kompjutera, por në dispozicion të bibliotekës janë vënë edhe disa laptopë. Shumica e auditorëve nuk kanë projektorë të instaluar apo laptopë, dhe si rrjedhojë, kur është e nevojshme, përdoren pajisje portative. [Turi te burimet e mësimnxënies] Wi-Fi ofrohet në të gjithë godinën dhe shumë studentë përdorin pajisjet e tyre portative. [M6] Duket se, teknologjitë e reja, si p.sh. tabelat interaktive, nuk janë futur ende, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re se instalimi elektrik i dy njësive të kondicionimit të ajrit në auditorë mund të jetë i rrezikshëm. [Turi i burimeve të mësimnxënies]. Personeli dhe studentët u shprehën të kënaqur me burimet e ofruara të teknologjisë së informacionit dhe se nuk dëshironin t'i përfitësonin ato. [M6; M10] [Kapitulli III Standardi VII.2; Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V1]

2.9 Godina kryesore e studentëve është pesëkatëshe dhe ashensori ekzistues është i papërshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara fizike, pasi është tepër i ngushtë për karriget me rrota. Krahas kësaj, ashensori nuk ofron akses në katin e pestë, ku ndodhen disa auditorë për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke përfshirë edhe bibliotekën. [Turi te burimet e mësimnxënies] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi papërshtatshmërinë e ambienteve për studentët me aftësi të kufizuara si **dobësi**, dhe si rrjedhojë, i **rekomandon** universitetit hartimin dhe zbatimin e një plani të caktuar, si çështje urgjente, për t'i siguruar studentëve

me aftësi të kufizuara akses në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies,. **[Kapitulli III Standardi V.1]**

- 2.10 Institucioni ruan si në format elektronik, ashtu edhe në format të shtypur, të gjithë dokumentacionin përkatës lidhur me studentët, personelin, infrastrukturën, politikat dhe procedurat. **[RVV fq.23-24]** Ruajtja bëhet e mundur nga Sekretaria. **[M11][Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.11 Biblioteka ka 860 libra, që përfshijnë 300 tituj, të cilat mund të huazohen nga studentët për një periudhë 20 ditore. **[Turi te burimet e mësimnxënies]** Gjithashtu, studentëve iu ofrohet akses online në afërsisht 10,000 tituj, të cilët janë të disponueshëm, nëpërmjet pajisjeve portative si brenda kampusit, ashtu edhe në distancë. **[Turi i burimeve të mësimnxënies]** Studentët e vlerësojnë disponueshmërinë online, por së bashku me personelin janë tejet kritikë kundrejt mungesës së librave në format të shtypur në bibliotekë, që shërbejnë për mbështetjen e mësimnxënies së tyre. **[M6; M10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi mungesën e librave në format të shtypur si **dobësi**, dhe si rrjedhojë i **rekomandon** universitetit rishikimin e stokut të librave në format të shtypur të bibliotekës, si çështje urgjente, për sigurimin e përmbushjes së nevojave të mësimdhënies dhe mësimnxënies së studentëve dhe personelit. **[Kapitulli III Standardi V.1]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një sistemi informacioni të koordinuar dhe të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- infrastruktura e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara (pika 2.9; **Kapitulli I Standardi VI.3**)
- mungesa e librave në format të shtypur në bibliotekë (pika 2.11; **Kapitulli II Standardi V.1**)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- identifikimi dhe instalimi i softuerit të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në të dhënat personale dhe në burimet e posaçme të mësimdhënies dhe mësimnxënies për çdo program studimi që ofrohet (pika 2.7; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- hartimi dhe zbatimi i një plani të caktuar, si çështje urgjente, për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimdhënies dhe mësimnxënies (pika 2.9; **Kapitulli I Standardi VI.3**)
- rishikimi i të gjithë stokut të librave në format të shtypur të bibliotekës, si çështje urgjente, për sigurimin e përmbushjes së nevojave të mësimdhënies dhe mësimnxënies së studentëve dhe personelit (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi V.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Institucioni i rendit dhe i përshkruan programet, që ofron, në faqen e tij të internetit. **[RVV fq.27; A70; <http://wisdom.edu.al>] Megjithatë, pavarësisht vënies në dispozicion me anë të kërkesës, specifikat e programeve nuk mund të aksesohen në faqen e internetit. **[A77; dokumentet 1-3 të ngarkuara në faqen e internetit]** Studentëve iu ofrohet më shumë informacion në Guidën e Studentit, ku publikohen hollësi, p.sh rreth të gjitha programeve të ofruara, ambienteve dhe vendndodhjes së institucionit, apo kërkesave për regjistrimin dhe diplomimin. **[A71]** Programet ndahen në module dhe bazohen në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve, ku për programet e ciklit të parë (Bachelor) jepen 180 kredite për tre vjet, ndërsa për programet të ciklit të dytë (Master) 120 kredite për dy vjet. **[RVV fq.27; A76-A78; M3-M5; M10] [Kapitulli I Standardi I.1]****
- 3.2 Institucioni komunikon me shkollat e mesme dhe merr pjesë në ditët e informimit, për informimin e studentëve të mundshëm rreth programeve të tij. **[RVV fq.27; M3-M5; M10]** Studentët u shprehën se informacioni që iu ofrohet përpara regjistrimit ishte i plotë dhe i saktë, dhe se faqja e internetit ishte e dobishme. **[M6]** Nga Anketimi i Studentëve rezultoi se 100 për qind e studentëve ishin të kënaqur me informacionin që iu ofrohej përpara fillimit të kursit. **[Anketimi i Studentëve]** Pranimi dhe regjistrimi i studentëve, duke përfshirë edhe kërkesat e pranimit dhe transferimit, përcaktohen në nenet 56 dhe 57 të Statutit, **[RVV fq.27; A1]** të cilat përshkruhen më në hollësi në rregulloret e institucionit. **[A10]** Studentët u shprehën se gjatë procesit të pranimit dhe regjistrimit nuk patën asnjë problem, dhe se menjëherë pas regjistrimit, iu ofrua informacioni përkatës dhe u ndjenë të mirëpritur. **[M6]** Studentëve të disa kategorive të caktuara iu jepen bursa, si p.sh studentëve me nota të shkëlqyera nga shkollat e mesme dhe studentëve që i përkasin grupeve sociale në vështirësi ekonomike, ndërsa studentëve që vijnë nga një familje mund t'iu bëhet ulje. **[A73; M11] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.3 Institucioni nuk ofron programe studimi me kohë të pjeshme apo kurse të shkurtra për përditësim profesional. **[RVV fq.28]** Megjithatë, ai përpiqet që, programet e ofruara me kohë të plotë, të sigurojnë përmbushjen e të gjitha nevojave të studentëve. **[RVV fq.28; M3-M5; M11]** Këtë gjë e realizon me anë të pyetësorëve të studentëve në fund të çdo semestri, pyetjet themelore të së cilave lidhen me cilësinë e leksioneve dhe pedagogëve, infrastrukturës dhe lëndëve që ndjekin. Zakonisht, pyetjet janë të mbyllura dhe hapësira për të komentuar rreth qëllimeve dhe rezultateve të programeve është e kufizuar. **[A72] [Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.4 Programet ofrohen në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit. **[RVV fq.28-29; A21; M2-M5]** Në Planin Strategjik të Zhvillimit (2012-2017) përcaktohet se misioni i universitetit është të krijojë, zhvillojë, nxisë, forcojë dhe të mbrojë një bazë të gjerë dhe të përshtatshme njohurish. Kjo gjë do t'i shërbente vendit, nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve të tjera në drejtësi, ekonomi

dhe shoqëri, në përputhje me zhvillimet sociale dhe ekonomike në vend.**[A18]**
[Kapitulli I Standardi I.3]

- 3.5 Programet e studimit përqendrohen kryesisht te nevojat e tregut të punës në Shqipëri, **[A1]** por studentëve, që synojnë të ndjekin programet e ciklit të dytë, iu kërkohet pasja e një minimumi njohurish, që të jenë në përputhje me normat e pranuar në shkallë ndërkombëtare.**[RVV fq.29; A1; A10; M10]** Institucioni ka lidhur marrëveshje me një sërë institucionesh të huaja, dhe personeli nxitet të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare. **[A35, A36, A38, A50 & A1126]** Megjithatë, nga Anketimet e Studentëve dhe të Stafit rezultoi se, në pesë vitet e fundit, 89.47 për qind e studentëve nuk kanë studiuar dhe 91.18 për qind e stafit nuk ka punuar jashtë vendit. **[Anketimi i Studentëve; Anketimi i Stafit]** Krahas kësaj, asnjërit prej studentëve, apo anëtarëve të stafit që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, nuk i ishte ofruar mbështetje nga institucioni për të udhëtuar jashtë vendit gjatë këtij viti akademik.**[M6; M10]** Siç theksohet edhe në pikën 1.10, mungesa e bashkëpunimeve me partnerë ndërkombëtarë, që i ofrojnë stafit dhe studentëve mundësi për mobilitet identifikohet si **dobësi.****[Kapitulli I Standardi I.4]**
- 3.6 Ngarkesa mësimore e stafit akademik planifikohet paraprakisht, në përputhje me kërkesat përkatëse.**[RVV fq.30]** Anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë pritet të japin gjashtë deri në dymbëdhjetë orë mësim në javë, gjë që përcaktohet edhe në kontratë, ndërsa pjesa e mbetur e orëve shpërndahet midis veprimtarive kërkimore apo veprimtarive të tjera të ngjashme. **[RVV fq.30; A75; A76; M10]** Veprimtaritë mësimdhënëse përfshijnë leksionet, seminarët, vlerësimet dhe praktikën profesionale dhe miratohen nga përgjegjësit e departamenteve. Katër anëtarët e stafit akademik me kohë të pjesshme japin më pak se katër orë mësim në javë, por ofrojnë ekspertizën e tyre prej specialistësh, kur është e nevojshme.**[RVV; fq.32; A10; M4; M10]****[Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.7 Programet e ofruara të studimit janë lehtësisht të kuptueshme, qartësisht të përcaktuara dhe të aksesueshme nga studentët.**[RVV fq.30&31; dokumentet 1-3 të ngarkuara në faqen e internetit]** Kriteret e pranimit janë përcaktuar qartësisht në Statut dhe rregullore. **[A1; A10]** Studentët pohuan se i kuptonin plotësisht kriteret e pranimit, si dhe qëllimet dhe objektivat e programeve që po ndiqnin.**[M6]** **[Kapitulli I Standardi I.6]**
- 3.8 Kurrikula e programeve ekzistuese hartohet çdo vit në bazë të propozimeve të stafit akademik, të cilat iu dërgohen fillimisht për miratim përgjegjësve të departamenteve dhe dekanëve, dhe më pas Senatit.**[RVV fq.29-32; M4; M10]** Ky proces nxitet nga përgjigjet e përftuara nëpërmjet pyetësorëve të studentëve apo pikëpamjet e stafit akademik.**[A72; M10]** Hartimi i programeve të reja bazohet te studimi i tregut, si për shembull ai i programit të Masterit në administrim biznesi.**[A25]** Ky i fundit është një dokument gjithëpërfshirës që mbulon, p.sh mundësitë që ofron tregu i punës dhe mundësitë për punësim, rastet e biznesit dhe nevojën për burime shtesë.**[Kapitulli I Standardi I.7]**

- 3.9 Komunikimi i vazhdueshëm me palët e jashtme të interesit për zhvillimin e kurrikulës është më pak i mirëpërcaktuar. **[M7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me një grup personalitetesh me ndikim, duke përfshirë Zëvendës Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, përfaqësues të punëdhënësve të mëdhenj në rajon dhe disa alumni. **[M7]** Të gjithë këta persona u treguan tejet mbështetës kundrejt institucionit dhe programeve të ofruara, por u shprehën se nuk kishte asnjë mekanizëm formal që të siguronte marrjen e sugjerimeve të tyre gjatë zhvillimit të kurrikulës. Aktualisht, ata diskutojnë rreth hartimit të programeve me pedagogë të shquar në rrugë joformale, por nuk mundën të ofronin asnjë shembull se si ky diskutim kishte ndikuar në hartimin e programeve. **[M7]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e sugjerimeve formale në zhvillimin e kurrikulës nga ana e palëve të jashtme të interesit si **dobësi**, dhe si rrjedhojë, i **rekomandon** universitetit lidhjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme, si çështje urgjente, për sigurimin e marrjes parasysh të sugjerimeve të palëve të jashtme të interesit në zhvillimin e kurrikulës, për sigurimin e përputhshmërisë së vazhdueshme të kësaj të fundit me nevojat e studentëve. **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.12]**
- 3.10 Institucioni shprehet se të gjitha programet kanë si objektiv parësor nxitjen e të menduarit kritik dhe debateve konstruktive, nëpërmjet të cilave synohet zhvillimi demokratik i studentëve dhe formimi i tyre si qytetarë të mirë në shërbim të shoqërisë, që përmbushin kërkesat e tregut të punës, duke dhënë kontributin e tyre në ekonominë dhe zhvillimin e vendit në tërësi. **[RVV fq.27]** Programet e ciklit të parë Bachelor i ofrojnë studentëve njohuritë dhe parimet themelore shkencore, të cilat mundësojnë përparimin e tyre në programet e ciklit të dytë të Masterit ose në punësim, që mbështetet me anë të praktikës profesionale. **[RVV fq.31-32; A67; dokumentet 1-3 të ngarkuara në faqen e internetit]** Programet e ciklit të dytë kanë një bazë qëndrueshme kërkimore dhe mbështeten plotësisht nga punëdhënësit dhe palët e jashtme të interesit. **[RVV fq.32; M7]** Alumni e vlerësojnë mësimin e parimeve teorike, pasi i ndihmojnë në përgatitjen për punësim. **[M7]** **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.8; Kapitulli I Standardi I.9; Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.11 Institucioni mbledh të dhëna statistikore të kufizuara rreth punësimit të të diplomuarve, si p.sh lidhur me statusin e punësimit, pagat, kënaqshmërinë me programet, etj. **RVV fq.32; B18]** Në përgjithësi, feedback-u për kënaqshmërinë rreth programeve ishte i mirë dhe ndryshonte nga 75 në 96 për qind. **[B18]** Shkalla e punësimit ishte më e ulët, pasi ndryshonte nga 44 në 54 për qind. Të dhënat statistikore për punësimin nuk janë të disponueshme në faqen e internetit të institucionit. **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.12 Pjesë e kurrikulës së të gjitha niveleve është edhe mësimnxënia e gjuhëve të huaja. **[RVV fq.33]** Studentët u shprehën se njëra prej lëndëve në vitin e parë dhe të dytë zhvillohej në gjuhën angleze, por krahas kësaj, nuk u përmend asnjë gjuhë tjetër. **[M6]** Megjithëse personeli u shpreh se lëndët nuk ofroheshin në gjuhën angleze, njëri prej pedagogëve me kohë të pjesshme tha se formimi i tij dhe zotërimi i gjuhës angleze i jepte mundësinë studentëve të njiheshin me

termat e biznesit në këtë gjuhë.**[M10]** Shumica e personelit që u takua me grupin e Vlerësimit të Jashtëm nuk ishin në gjendje të komunikonin në anglisht dhe aftësitë e studentëve në gjuhën angleze ishin shumë më të mira sesa ato të pedagogëve. Me të përfunduar me sukses programin e tyre të studimit, studentë pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, ku ofrohen hollësi rreth lëndëve/moduleve, nivelit dhe krediteve.**[M2-M6; M10; M11][Kapitulli I Standardi I.10]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e sugjerimeve formale të palëve të jashtme interesit për zhvillimin e kurrikulës (pika 3.9; **Kapitulli I, Standardi I.7; Kapitulli I, Standardi I.12**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- lidhja e një marrëveshjeje të qëndrueshme, si çështje urgjente, për sigurimin e marrjes parasysh të sugjerimeve të palëve të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të kurrikulës, për sigurimin e përputhshmërisë së vazhdueshme të kësaj të fundit me nevojat e studentëve (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.12**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Në fillim të çdo viti akademik, institucioni siguron organizimin efikas të programeve të studimit që ofron. Planet mësimore dhe syllabuset mbahen dhe ruhen në fakultetet dhe në departamentet përkatëse. **[RVV fq.34-36; A82; M3; M4]** Programet hartohen fillimisht nga grupi i punës dhe nga profesorët përkatës, emrat e të cilëve përfshihen në dosjet e licensimit të programeve përkatëse. Krahas kësaj, çdo semestër, programet iu nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga stafi akademik. **[RVV fq.34-36; A83; M2-4]** Në programet e studimit Bachelor, praktikat profesionale në fund të vitit të tretë zhvillohen në institucionet e miratuara nga Dekanati dhe nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të departamentit. Gjatë praktikës profesionale, studentët vlerësohen me notë njësoj si në lëndët e tjera, si dhe janë të detyruar të respektojnë rregullat e institucionit, duke përfshirë edhe rregullat për frekuentimin. **[RVV fq.34; A7; M6; M10]**
[Kapitulli I Standardi II.1]
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat për provime përcaktohen në rregulloret e institucionit dhe të programeve. **[RVV fq.36-37; A7; M3; M10]** Datat e provimeve shpallen paraprakisht në faqen e internetit ose afishohen në ambientet e institucionit, dhe janë të aksesueshme nga të gjithë anëtarët e stafit dhe studentët. **[RVV fq.36-37; M3; M6; M10]** Gjatë korrigjimit të provimeve dhe shpalljes së rezultateve ruhet anonimiteti. **[A85; M6; M11]** Ankimimet për notat e provimeve shqyrtohen nga komisioni i ngritur në përputhje me rregulloret e provimeve. **[RVV fq.36-37]** Studentit ia dorëzon ankimimin me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orësh pas komunikimit të notës së provimit. Nëse çështja nuk zgjidhet, njoftohet Dekani i Fakultetit. Ky i fundit, brenda 48 orëve pas njoftimit nga përgjegjësi i departamentit, ngre komisionin e posaçëm, i cili heton pretendimin e studentit. Vlerësimi përfundimtar i provimit bëhet nga komisioni, me miratimin e Dekanit. **[Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 Institucioni i përmirëson vazhdimisht standardet dhe cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet strukturave të tij. **[RVV fq.39-40; M2-M6; M10; M11]** Në fillim të çdo viti akademik, i gjithë personeli përditëson syllabusin në lidhje me futjen e temave të reja dhe propozimin e literaturës së re (siç përmendet në pikën 4.1). Për shembull, ndryshimet kushtetuese në korrik të vitit 2016 u shoqëruan me përditësimin e kurrikulës së programit Bachelor të së Drejtës Kushtetuese. **[RVV fq.37; A82; A83; M10]**. Përgjegjëse për mbikëqyrjen e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies në të gjithë institucionin është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[RVV fq.39-40; A10]** Ajo organizon pyetësorët e stafit dhe studentëve, mbledhjet e përbashkëta në shkallë departamenti dhe intervista me studentë për mbledhjen e informacioneve, ku do të mbështetet vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies. **[RVV fq.39-40; A92-A94; M3]**. Studentët përfshihen në vlerësimin e ofrimit të leksioneve dhe programeve të studimit. **[RVV fq.37; A88; A89; M6]** Në fund të çdo semestri, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë analizon të dhënat e përfuara nga pyetësorët e studentëve. Studentët u

shprehën se feedback-u i tyre merret parasysh. Për shembull, ata ishin ankuar për cilësinë e mësimdhënies në lëndën e së Drejtës financiare, gjë që u shoqërua me ndërrimin e stafit mësimdhënës. **[RVV fq.37-38; A93; M3; M6]**
[Kapitulli I Standardi II.3; Kapitulli I Standardi II.4]

- 4.4 Universiteti u shpreh se stafit dhe studentët nxiten të ndërmarrin kërkime shkencore, dhe se synon të rekrutojë staf akademik të kualifikuar në këtë fushë. **[RVV fq.41-42; M2-M5; M10; M11]** Institucioni ka ftuar edhe një sërë lektorësh të huaj për të dhënë leksione të hapura për stafin dhe studentët, të cilët jo vetëm që kanë pranuar, por edhe i kanë mbajtur këto leksione të hapura, si p.sh në fushën e çështjeve gjyqësore civile në kuadrin e marrëveshjes ndërmjet institucionit austriak dhe Kolegjit Universitar “Wisdom”, në ambientet e këtij të fundit. **[RVV fq.41; A41; A116; A119; A122; A123; M6; M10]** Përfundimet e konferencave dhe veprimtarive kërkimore të personelit publikohen online dhe në format të shtypur. **[RVV fq.42-43; A97; A120; M10]** **[Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6; Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8]**
- 4.5 Wisdom pranon se, duke qenë një institucion relativisht i ri në ndërmarrjen kërkimore shkencore, vijimësia e kërkimeve shkencore dhe informimi rreth transferimeve të rezultateve në këtë fushë janë ende në fazat e para të zhvillimit. Gjatë mbledhjeve me anëtarët e Senatit dhe stafit akademik, nuk u identifikua asnjë prioritet institucional i kërkimit shkencor. **[M4; M5; M10]** Megjithëse institucioni nxit ndërmarrjen dhe dinamizmin e kërkimit shkencor, kjo gjë tregohet vetëm me pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme të organizuara nga institucioni, si dhe me botimin e revistës së institucionit të quajtur “Revista Periodike e Wisdom-it”. **[RVV fq.43; M3; M10]** Megjithatë, institucioni nuk ka asnjë strategji zyrtare kërkimore dhe nuk është i qartë rreth proceseve për përcaktimin dhe rënien dakord në lidhje me prioritetet kërkimore institucionale. **[RVV fq.41-43]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi mungesën e një strategjie zyrtare kërkimore për përcaktimin e prioritetëve në shkallë institucioni dhe departamenti si **dobësi**, dhe si rrjedhojë i **rekomandon** universitetit hartimin dhe zbatimin e një strategjie zyrtare kërkimore, si çështje urgjente, për përcaktimin e prioritetëve kërkimore në shkallë institucioni dhe departamenti. **[Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5]**
- 4.6 Në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe me Statutin, departamentet përkatëse janë njësitë kryesore vendimmarrëse për mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin dhe kërkimin. Megjithatë, pavarësisht fakteve të qarta, që tregojnë se kjo gjë është e vlefshme për funksionet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti ta konfirmonte rolin e departamenteve në evidentimin e pikave të fortave dhe të dobëtave lidhur me kërkimin shkencor. **[RVV fq.40; A1; M10]** Grupi i Vlerësimit të jashtëm e identifikoi mungesën e prioritetëve, analizave dhe diskutimeve specifike kërkimore si **dobësi**, dhe si rrjedhojë i **rekomandon** universitetit marrjen e masave, si çështje urgjente, për sigurimin e nxitjes, koordinimit dhe

drejtimin të punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore të ngritura. **[Kapitulli II Standardi I.1]**

4.7 Institucion shprehet se në qendër të axhendës së tij për ndërkombëtarizimin kërkimor është vendosur organizimi i konferencave shkencore dhe ndjekja e tyre nga stafi. **[RVV fq.41; M2-M5; M10; M11]** Megjithëse institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh me institucionet e huaja të arsimit të lartë me qëllim ndërmarrjen e veprimtarive kërkimore, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprimtari e tillë në bashkëpunim me partnerët. **[M10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi mungesën e veprimtarive kërkimore në bashkëpunim me partnerët si **dobësi**, dhe si rrjedhojë i **rekomandon** universitetit hartimin dhe zbatimin e një plani të përcaktuar për sigurimin e zhvillimit të një axhende ndërkombëtarizimi, në qendër të së cilës të vendosen kryesisht angazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe bashkëpunimi me institucionet e huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi. **[Kapitulli II, Standardi I.3]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një strategjie zyrtare kërkimore për përcaktimin e prioriteteve, në shkallë institucioni dhe departamenti (pika 4.5; **Kapitulli II, Standardi I.4; Kapitulli II, Standardi I.5**).
- mungesa e prioriteteve, analizave dhe diskutimeve specifike kërkimore brenda departamenteve (pika 4.6; **Kapitulli II, Standardi I.1**)
- mungesa e veprimtarisë kërkimore në bashkëpunim me partnerë, dhe mosangazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- hartimi dhe zbatimi i një strategjie zyrtare kërkimore, si çështje urgjente, për përcaktimin e prioriteteve kërkimore në shkallë institucioni dhe departamenti (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5**)
- sigurimi i marrjes përsipër të përgjegjësisë nga ana e departamenteve, si çështje urgjente, për nxitjen, koordinimin dhe drejtimin e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore të ngritura (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- hartimi dhe zbatimi i një plani të përcaktuar për sigurimin e zhvillimit të një axhende ndërkombëtarizimi, në qendër të së cilës të vendoset kryesisht angazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimi me institucionet e huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Institucioni organizon për maturantët e shkollave të mesme të Tiranës dhe qyteteve të tjera fushata informimi lidhur me karrierën. **[RVV fq.44]** Gjithashtu, maturantëve iu ofrohet informacion rreth institucionit, programeve të studimit dhe kriterëve të pranimit. Për më tepër, institucioni, në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale, organizon ditët e orientimit për zgjedhjen e karrierës për nxënësit e shkollës së mesme. **[RVV fq.44; M4]** Institucioni ndjek politikat e duhura për mirëpritjen dhe integrimin e studentëve të rinj. **[B31]** Kriteret e pranimit për vitin akademik 2017-2018 janë miratuar nga Senati bazuar në notën mesatare të shkollës së mesme, notën mesatare të lëndëve specifike dhe në intervistën. **[RVV fq.44; A107; M4]** Raporti studentë dhe pedagogë i përmbush kërkesat staturore. **[RVV fq.44; M4; M6; M10]** **[Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 Struktura e institucionit për informimin dhe këshillimin e studentëve është e përshtatshme. **[RVV fq.44-45; B32]** Në harkun kohor të një viti akademik planifikohen dy mbledhje midis studentëve dhe pedagogëve, përkatësisht njëra në semestrin e parë dhe tjetra në të dytin. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës Studentore ndjekin dhe mbështesin performancën akademike dhe profesionale të studentëve, duke përfshirë edhe informimin për caktimin në praktikë, ose mundësitë e punësimit në institucionet partnere, për formimin profesional, forumet rinore dhe aplikimet e mundshme në konferenca kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. **[RVV fq.44-45; A117; M3; M6]** Çdo vit akademik, institucioni iu ofron studentëve Guidën e Studentit, e cila jep informacion të përgjithshëm rreth shërbimeve kryesore të ofruara nga institucioni dhe disponohet në bibliotekë, por mund të aksesohet edhe online. **[RVV fq.44-45; A71; M3; M6]** Për t'i mbështetur studentët, personeli administrativ, kryesisht Sekretaria, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës Studentore ofrojnë informacione shtesë me email ose ballë për ballë. **[RVV fq.45; A55; A107; M6; M11]** Dosjet personale të studentëve, që ruhen në mënyrë të sigurt në Sekretarinë Mësimore, përmbajnë adresën elektronike të studentit dhe numrin e tij të kontaktit, si dhe të njërit prej pjesëtarëve të familjes së tij. **[RVV fq.45; A108; M11]** **[Kapitulli I Standardi III.2; Kapitulli I Standardi III.3]**
- 5.3 Institucioni nxit, me anë të politikave mbështetëse, pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari sportive. **[RVV fq.46; M6]** Studentët që i përkasin grupeve të caktuara sociale, ose që marrin ndihmë sociale apo janë në vështirësi financiare, përfitojnë bursë për reduktimin e tarifës së shkollimit në programet e ciklit të parë Bachelor. Bursat për reduktimin e tarifave janë të disponueshme edhe për studentët me performancë të lartë dhe familjet që kanë mbi tre fëmijë apo që janë në vështirësi financiare. **[RVV fq.46; A73; A109; M6; M11]** **[Kapitulli I Standardi III.4]**
- 5.4 Siç vihet re edhe në pikën 2.11, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e librave në format të shtypur në bibliotekë si **dobësi**. Biblioteka e vogël e institucionit i ofron studentëve, stafit akademik dhe personelit administrativ materiale dhe shërbime falas. Krahas kësaj, studentët dhe

personeli kanë akses edhe në bibliotekën online. **[RVV p.46; Turi te burimet e mësimnxënies]** Çdo vit, për të mbështetur programet e studimit, stafi akademik dhe departamentet hartojnë plane të hollësishme për shtimin e artikujve të bibliotekës. **[RVV fq.47; M6; M10]** Fondi i bibliotekës është pasuruar edhe falë dhurimeve të anëtarëve të personelit, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të veprimtarisë kërkimore, si dhe organizatave. **[RVV fq.47; M10]** Orari zyrtar i bibliotekës (nga e hëna në të premte, 09.00-19.30) publikohet në tabelat e njoftimit. Për të marrë dhe huazuar libra, studentët dhe stafi pajisen me kartë regjistrimi. **[RVV fq.46; A111; Turi i burimeve të mësimnxënies]** **[Kapitulli I Standardi III.5]**

5.5 Institucioni iu ofron studentëve udhëheqje, këshillim dhe kujdes përmes një sistemi mentorësh dhe këshilluesish akademikë, të caktuar nga Dekani i Fakultetit. **[RVV fq.47; A112; B32; M6; M10]** Studentët e Bachelor-it zgjedhin për temë diplome njërën prej temave të renditura në listën e ofruar nga fakulteti, por mund të propozojnë edhe temat e tyre, nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Karrierës dhe Jetës Studentore, të cilat më pas miratohen nga Dekani përkatës. **[RVV fq.47; M6; M10]** Studentëve iu ofrohet këshillim dhe mbështetje rreth literaturës, që miratohet nga departamenti përkatës dhe, përgjithësisht, disponohet në bibliotekë. **[RVV fq.47; A1; M4; M10]** Për të ndihmuar studentët në marrëdhënie pune, orët e mësimit të programeve të ciklit të dytë Master zhvillohen pasdite. **[RVV fq.47; A124; M6; M10]** **[Kapitulli I Standardi III.6]**

5.6 Studentët përfaqësohen në organet drejtuese institucionale nga anëtarët e zgjedhur të Këshillit Studentor. **[RVV fq.48; A113; M3; M6]** Departamentet dhe fakultetet organizojnë mbledhje periodike me përfaqësuesit e studentëve për mundësimin e dhënies së feedback-ut të tyre rreth çdo aspekti të përvojës studentore. **[RVV fq.48; M3; M6]** Institucioni i mbështet financiarisht veprimtaritë dhe klubet e organizuara nga Këshilli Studentor, veçanërisht veprimtaritë e orientimit të studentëve dhe ato sportive. **[RVV fq.48-49; M6]** **[Kapitulli I Standardi III.8]**

5.7 Institucioni ndjek politika për t'i ndihmuar studentët me punësimin e tyre. **[RVV; A49-51; M7]** Zyra e burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës studentore komunikon rregullisht me institucionet partnere dhe departamentet e burimeve njerëzore të institucioneve publike dhe private. Zyrat mbajnë në format elektronik të dhënat e ecurisë profesionale të studentëve, duke përfshirë informacionet për punësimin aktual ose të mundshëm të studentëve dhe të diplomuarve. **[RVV 49; A51; M11]** Zyrat i përditësojnë studentët me informacion rreth mundësive që ofron tregu i punës, sipas profilit të tyre të studimit, **[RVV fq.50; M11]** si dhe organizojnë aktivitete për t'i mbajtur studentët në kontakt me tregun e punës. Si shembull mund të merren prezantimet e kompanive të ndryshme, që ofrojnë mundësi punësimi, në ambientet e kampusit, dhe stazhet ose leksionet e hapura, që synojnë përgatitjen e studentëve për tregun e punës. **[A118-A121; M6; M7]** **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Lista 1

Këto dokumente u dorëzuan nga universiteti si dokumente shoqëruese të Raportit të Vetëvlerësimit. Numri i dokumenteve të renditura është 154, por ka edhe dokumente të renditura në faqet 54-58 të Raportit të Vetëvlerësimit, por në këtë rast, janë renditur 134 dokumente, gjë që pasqyrohet edhe në këtë listë. Në këtë raport, këto dokumente referohen si **A1, A2** etj.

- A1 Statuti i SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A2 Vendimi nr. 7, datë. 17.11.2016, “Për ngritjen e Komisionit të Brendshëm të Vlerësimit për akreditimin institucional”
- A3 Plani i punës i Grupit të Brendshëm të Vlerësimit për akreditimin institucional të Kolegjit Universitar “Wisdom”
- A4 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 27.09.2006 “Për lejen e hapjes së institucionit jopublik të arsimit të lartë “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A5 Vendimi i Këshillit të Akreditimit të APAAL-it së bashku me Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për programin e studimit Bachelor në Drejtësi dhe Psikologji.
- A6 Vendimi i Këshillit të Akreditimit të APAAL-it së bashku me Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për programet e studimit Master.
- A7 Vendim i Këshillit të Akreditimit të APAAL-it nr. 214, datë 29.07.2011
- A8 Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nr. 412, datë 25.08.2011.
- A9 Urdhri i MAS nr. 237, datë 09.05.2016 “Për plotësimin e kushteve për akreditimin institucional të institucionit jopublik të arsimit të lartë “Kolegji Universitar Wisdom”, të themeluar me Urdhrin nr. 355, datë 25.09.2015 “Për akreditimin e kushtëzuar në nivel institucional të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”. Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit për heqjen e kushtit për akreditimin e mësipërm, datë 02.18.2016.
- A10 Rregullorja e SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A11 Vendimi nr. 1, datë 02.10.2011 i Senatit të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A12 Nenet 7-11, Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Senatit të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A13 Vendimi nr. 8, datë 15.10.2015 i Senatit Akademik “Për miratimin e Këshillit të Etikës”.
- A14 Kodi i Etikës i miratuar me vendimin nr. 10, datë 15.10.2015 të Senatit Akademik.
- A15 Përbërja e senatit, vendimi për emërimin e Senatit Akademik të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A16 Vendimi për ngritjen e NJSBC-së së SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A17 Rregullore për funksionimin e NJSBC-së së SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A18 Plani Strategjik Pesëvjeçar i Zhvillimit të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”, për periudhën 2012-2017.
- A19 Plani i punës i NJSBC-së për vitin akademik 2016-2017.
- A20 Plani Strategjik i Cilësisë 2016-2018 i SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A21 Vendimi për themelimin e institucionit.
- A22 Udhëzimi nr. 1 datë 28.02.2011 “Për procedurat dhe dokumentet e kërkuara për hapjen e një institucioni jopublik të arsimit të lartë, programeve universitare të ciklit të parë dhe ciklit të dytë, programeve jouniversitare, programeve profesionale dhe procedurave për pezullimin dhe anulimin e licensës”, Kreu IV.B. Shihni shtojcën Organizimi dhe Menaxhimi, seksioni 23.
- A23 Shkresa nr. 149, datë 04.10.2016, për dorëzimin e raportit Ministrisë së Arsimit.

- A24 Stafit akademik (kualifikimet dhe titujt përkatës) në departamentet e dy fakulteteve të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”. Neni 14 i Kodit të Etikës dhe neni 4 i Rregullores së Këshillit të Fakultetit.
- A25 Studim tregu i departamentit të Ekonomisë, seksioni “Tregu i punës për profesionin e ekonomistit”.
- A26 Studim tregu për programin e studimit në Fakultetin e Drejtësisë.
- A27 Studim tregu në programin e studimit Bachelor dhe Master i Shkencave në Psikologji.
- A28 Rregullorja e Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
- A29 Plani i veprimtarisë së Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, 2016-2017.
- A30 Abonimi në revistën e drejtësisë.
- A31 Projekti “Mbledhje me alumni” në SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A32 Misioni dhe qëllimi i Aktit të Themelimit të IKZHW-së.
- A33 Lista e aplikimeve të IKZHW-së në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe faqja përkatëse e internetit.
- A34 Deklarata e Angazhimit dhe regjistrimi në faqen e Komisionerit Evropian.
- A35 Marrëveshje me Kolegjin MBS të Kretës.
- A36 Axhenda e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare me Institutin Evropian në lidhje me menaxhimin, drejtësinë dhe diplomacinë.
- A37 Marrëveshje me agjencitë publike dhe private për stazhet e studentëve.
- A38 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. (tabela e përmbledhjes).
- A39 Ftesë nga CILS (Qendra për Studime Ligjore në Austri) për pjesëmarrjen e stafit, 2 thirrje, thirrje për aplikim nga Teramosi. Fotografi.
- A40 Shkresë nga Alumni e CILS për profesorët amerikanë të institucionit.
- A41 Axhenda e leksioneve për profesorët amerikanë.
- A42 Shkresë Alumni nga CILS për profesorin e ri në institucion, J.D. Andrew Nea.
- A43 Përmbledhje dhe dokumente shtesë nga leksioni i hapur i lektorit britanik, Andy Zdan Michajlowitz.
- A44 Propozimet e departamentit dhe vendimet e Njesisë së Kërkimit Shkencor për organizimin e leksioneve të hapura nga lektorët e ftuar (procedura, si do të zhvillohet)
- A45 Praktika e rekrutimit të stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Sociale të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A46 Lista e plotë e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A47 Lista e plotë e veprimtarisë botuese të stafit akademik të Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A48 Modeli i kontratës së punës së SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A49 Organigrama e SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A50 Kalendar i veprimtarive të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A51 Statistikat e punësimit të stafit akademik të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A52 Modeli i Raporti të Vetëvlerësimit të stafit akademik të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A53 Kalendar i Kontrollit të Cilësisë së Brendshme të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A54 Modeli i Kontrollit të Cilësisë së Brendshme për Mësimdhënien dhe Matjet e Performancës së pedagogëve, në semestrin e parë të vitit akademik 2016-2017.
- A55 Rregullorja e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Karrierës dhe Jetës Studentore të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A56 Shembull i dosjes personale.

- A57 Vendimi për emërimin e kancelarit të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A58 Të dhënat e Zyrës së Financës.
- A59 Raporti i Zyrës së Financës.
- A60 Fotografi të sallave të leksioneve të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A61 Fotografi të bibliotekës së SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A62 Fotografi të zyrës së stafit akademik të SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A63 Planimetria dhe kontratat e qiramarrjes së godinave, bashkëlidhur raportit.
- A64 Botimi i revistës së Wisdom.
- A65 Format i recensionit të një artikulli shkencor.
- A66 Të dhënat për mjedisin e SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”, që përdoren nga stafi akademik për veprimtari akademike.
- A67 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që ndihmojnë në ofrimin e praktikave profesionale.
- A68 Kontrata e punës për personelin e sigurisë dhe mirëmbajtjes.
- A69 IT-ja e institucionit, Z. Ardian Sinani.
- A70 Lista e programeve të studimit të ofruara nga SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”, me të dhënat përkatëse për licensimin dhe akreditimin.
- A71 Guida e Studentit të SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A72 Modeli i pyetësorit të studentëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënës dhe mësimnxënës në SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A73 Shkresë/protokoll për dhënien e bursave për studentët e shkëlqyer.
- A74 Udhëzim nr. 52, datë 03.12.2015 “Për vlerësimin e nivelit të gjuhëve të huaja dhe provimet ndërkombëtare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- A75 Plani Vjetor i Zyrës së Kurrikulave për vitin akademik 2016-2017.
- A76 Udhëzim nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e stafit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- A77 Modeli i syllabusit të lëndës “Menaxhimi Operacional”, i programit të studimit Administrim Biznesi në ciklin e parë të studimit Bachelor
- A78 Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Kurrikulës së Kolegjit Universitar Wisdom”
- A79 Udhëzimet nr. 4 datë 22.01.2008, nr. 14 datë 03.04.2008, dhe nr. 15 datë 04.04.2008 i MASH-it
- A80 Rregullorja e SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom” për regjistrimin dhe transferimin e studimeve në Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A81 Modeli i dosjeve të procedurave të transferimit për Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të Fakultetin e Drejtësisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore të SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A82 Procedurat për miratimin e planeve mësimore të programeve të ofruar të studimit.
- A83 Procedurat për miratimin e lëndëve të programit.
- A84 Rregullore për funksionimin e bibliotekës së SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A85 Marrëveshja e SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom” me Proquest-in.
- A86 Procedura e miratimit të strukturës për vitin akademik.
- A87 Procedura e dorëzimit të ankimimit nga studenti.
- A88 Modeli i ndryshimit të një syllabusi. Procedura.
- A89 Modeli i përmirësimit të syllabusit. Modeli i syllabusit të lëndës “Marketing Ndërkombëtar”.
- A90 Përbërja e njësisë, ku do të përfshihen edhe studentët. Vendimi për emërimin.
- A91 Plani i Punës së Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Karrierës dhe Jetës studentore të SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom” për vitin akademik 2016-2017.

- A92 Modeli i pyetësorit të personelit dhe një pyetësor i plotësuar.
- A93 Përmbledhje e mbledhjeve të përbashkëta të departamenteve të fakulteteve përkatëse dhe studentëve.
- A94 Raporti dorëzuar Rektorit të SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom” lidhur me raportet semestrale të stafit akademik për lëndën që japin dhe një model të plotësuar.
- A95 Kopje e formatit të raportit për veprimtarinë e kërkimit shkencor të stafit akademik për vitin akademik 2016-2017.
- A96 Vendimi i Administratorit nr. 1, datë 12.01.2017 ku ofrohet financimi për mbështetjen e veprimtarive shkencore (realizimi i vazhdueshëm i botimeve shkencore, seminareve dhe konferencave të tjera shkencore, mobilitetit të anëtarëve të stafit akademik etj. për vitin akademik 2016-2017)
- A97 Botimi i William Polk-ut në Librin e Punimeve të Konferencës.
- A98 Axhenda e veprimtarisë “Seminar për specializimin dhe novacionin inteligjent, TAIEX”
- A99 Fotografi nga veprimtaria “Dita e Informimit” për programet evropiane në kërkim shkencor dhe novacion.
- A100 Fotografi të seminareve të veprimtarisë “Dita e Informimit” HORIZONS 2020, organizuar nga AKTI dhe IKZHW
- A101 Shkresat e Zyrës së Burimeve Njerëzore për personelin e punësuar me kohë të pjeshme në institucionet e tjera dhe pozicionin e tyre të punës.
- A102 Plani vjetor i departamenteve.
- A103 Materiale mbështetëse si: axhenda, ftesa dhe broshura për aktivitetet shkencore të institucionit.
- A104 Botimet e studentëve në axhendën e botimeve të institucionit dhe seminareve të studentëve.
- A105 Libri i Punimeve të Konferencës, ISBN.
- A106 Procedurat që ndiqen nga institucioni ynë lidhur me miratimin e programeve të studimit të ciklit të parë në përputhje me nenin 74, pjesa
- A107 Pranimi në ciklin e parë të studimit në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
.2. Rregullorja e Sekretarisë. Neni për komunikimin me studentët.
- A108 Modeli i dosjes personale të studentit.
- A109 Procedura e dhënies së bursave. Bursat që janë dhënë ndër vite.
- A110 Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
- A111 Modeli i kartës së regjistrimit në bibliotekën e SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A112 Lista e udhëheqësve të Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore për vitin akademik 2016-2017.
- A113 Raporti i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Karrierës dhe Jetës studentore nr. 61, datë 08/11/2016 “Për riorganizimin e klubeve studentore dhe zgjedhjet e qeverisë studentore”.
- A114 Raporti i NJSBC-së për plotësimin e pyetësorëve për semestrin e parë të vitit akademik 2016-2017.
- A115 Marrëveshje bashkëpunimi për sigurimin e infrastrukturës sportive.
- A116 Shembuj konferencash, leksionesh të hapura, seminaresh, një sërë diskutimesh dhe debatesh, projektsh studentësh në partneritet etj. për të treguar angazhimin e studentëve në SHLUJ “Kolegji Universitar Wisdom”.
- A117 Raporti për veprimtaritë dhe ecurinë e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Karrierës dhe Jetës Studentore “Kush i punësoi të diplomuarit e SHLUJ-së “Kolegji Universitar Wisdom”
- A118 Universiteti me dyer të hapura. Materiale mbështetëse për këtë veprimtari.
- A119 Ftesa pjesëmarrjeje në mbledhje dhe diskutime me personalitetet të vendit, por edhe me ambasadorë.

- A120 Java Evropiane, 4-9 maj 2017 Shkup, Maqedoni. Shini shtojcën: Studentët dhe Mbështetja e tyre, pjesa 29.
- A121 Prezantimi i kompanive të ndryshme që ofrojnë mundësi punësimi dhe stazhi.
- A122 Dokumente mbështetëse për leksionin e hapur të titulluar “Hapat e parë drejt një karriere të suksesshme”, organizuar më 10.04.2017 nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Karrierës dhe Jetës Studentore
- A123 Materiale mbështetëse për leksionin e hapur të titulluar “Punësimi i të rinjve në Shqipëri, sfidat dhe vështirësitë”, mbajtur nga lektori i ftuar Z. Neshat Zeneli, përfaqësues i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
- A124 Leksionet/seminaret e programit të studimit Master i Shkencave dhe Master Profesional jepen pasdite për t’iu ardhur në ndihmë studentëve në marrëdhënie pune
- A125 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomie dhe Shoqërore
- A126 Rregullorja e Departamentit të Ekonomisë
- A127 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Administrim Biznesi
- A128 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Financë-Bankë
- A129 Rregullorja e Departamentit të Psikologjisë
- A130 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Drejtësi
- A131 Rregullorja e programi të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Civile dhe Tregtare
- A132 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në të Drejtë Penale
- A133 Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Publike
- A134 Rregullorja e Departamentit të së Drejtës Private

Dokumentet e mëposhtme janë publikuar në faqen e internetit, por nuk janë renditur në Raportin e Vetëvlerësimit. Këto dokumente referohen në raport si **dokumenti 1 i ngarkuar në faqen e internetit, dokumenti 2 i ngarkuar në faqen e internetit** etj.

1. Dosja e syllabuseve në programin e studimit Bachelor në Drejtësi
2. Dosja e syllabuseve në programin e studimit Bachelor në Psikologji
3. Dosja e syllabuseve në programin e studimit Bachelor në Ekonomi

Lista 2

Këto dokumente u dorëzuan nga universiteti me kërkesë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për qartësimin e dokumenteve mbështetëse fillestare, dhe referohen në raport si **B1, B2**, etj.

- B1 Fusha e Vlerësimit 1 Organizimi dhe Menaxhimi i tij, Pika 1. Dokumentet e ndryshimeve të statutit dhe rregulloreve.pdf.
- B2 Fusha 1 Pika 1 Këshilli i Fakultetit.pdf
- B3 Fusha 1 Pika 2 Bordi.pdf
- B4 Fusha 1 pika 2 Senati.pdf
- B5 Fusha 1 pika 2 Rektorati.pdf
- B6 Fusha 1 Pika 2 Këshilli i Etikës.pdf
- B7 Fusha 1 Pika 2 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.pdf
- B8 Fusha 1 Pika 3 Dokumente për ndarjen e qartë të veprimtarive midis organeve administrative nga ato drejtuese.pdf
- B9 Fusha 1 Pika 4 Organigrama.pdf
- B10 Fusha 1 Pika 5 Mekanizmat për monitorimin e efikasitetit të zbatimit të vendimeve.pdf
- B11 Fusha 1 Pika 6 Qartësimi i rolit të Institutit për Kërkim dhe Zhvillim “Wisdom” dhe marrëdhënia me universitetin.pdf
- B12 Fusha 1 Pika 7 Kopje e raportit vjetor 2015-2016.pdf

- B13 Fusha 1 Pika 8 Kopje e veprimtarisë vjetore të Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.pdf
- B14 Fusha 1 Pika 9 Dokumentet që tregojnë se gjatë hartimit të programeve të reja merren parasysh kërksat e ekonomisë vendore dhe tregut të punës.pdf
- B15 Fusha 2 Pika 10 Qartësimi i procesit për sigurimin e kontraktimit së një stafi akademik me kualifikimet dhe përvojën e duhur për mësimdhënien e programeve.pdf
- B16 Fusha 2 Pika 11 Informacion për procesin e vlerësimit të aftësive të personelit.pdf
- B17 Fusha e Vlerësimit 2 Pika 12 Informacion për procesin e hartimit, monitorimit dhe kontrollit të buxhetit.pdf
- B18 Fusha 3 Pika 13 Përmbledhje e sektorëve/vendeve të punësimit të të diplomuarve sipas programeve.pdf
- B19 Fusha 3 Pika 14 Modeli i rezultateve të përfuara nga pyetësorët e studentëve.pdf
- B20 Fusha 3 Pika 15 Procedura e ankesave dhe ankimimit që iu ofrohet studentëve.pdf
- B21 Fusha 3 Pika 16 Shembujt e informacioneve të tjera që i janë ofruar studentëve.pdf
- B22 Fusha 3 Pika 17 Shembujt e çështjeve të trajtuara nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë.pdf
- B23 Fusha 4 Pika 18 Të dhëna që tregojnë se institucioni respekton dhe ruan konfidencialitetin e rezultateve personale të provimeve.pdf
- B24 Fusha 4 Pika 19 Shembujt e proceseve për përmirësimin e programeve, me përfshirjen e studentëve.pdf
- B25 Fusha 4 Pika 20 Qartësimi i procesit për botimin e përfundimeve të provimeve dhe konkurseve.pdf
- B26 Fusha 4 Pika 21 Shembujt e të dhënave të punësimit të studentëve.pdf
- B27 Fusha 4 Pika 22 Qartësimi i mekanizmave që matin cilësinë e mësimdhënies.pdf
- B28 Fusha 4 Pika 23 Qartësimi i prioriteteve kërkimore të universitetit.pdf
- B29 Fusha 4 Pika 24 Informacion për politikat e nxitjes së kulturës së kërkimit në shkallë rajonale dhe kombëtare.pdf
- B30 Fusha 5 Pika 25 Informacion për zhvillimin e projekteve në mes të sezonit, të hartuara në përputhje me politikat e pranimit të studentëve.pdf
- B31 Fusha 5 Pika 26 Informacion për politikat specifike për tërheqjen dhe integrimin e studentëve të rinj dhe politika për mirëpritjen e studentëve të huaj.pdf
- B32 Fusha 5 Pika 27 Qartësimi i strukturave për udhëheqjen dhe këshillimin e studentëve gjatë të gjithë cikleve të studimit.pdf
- B33 Fusha 5 Pika 28 Informacion për nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarive sportive.pdf
- B34 Fusha 5 Pika 29 Shembujt e ofrimit të mbështetjes financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor dhe atyre kulturore.pdf
- B35 Fusha 5 Pika 30 Informacion dhe shembujt e politikave për favorizimin e punësimit të të diplomuarve.pdf

Lista 3

Këto dokumente, të cilat referohen në raport si **C1, C2** etj. u dorëzuan nga universiteti me kërkesë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit.

- C1 Plani i Veprimit të Grupit të Vetëvlerësimit .PDF
- C2 Plani i Veprimit të Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.PDF
- C3 Informacion për procesin e përmirësimit të programeve të studimit (1).pdf
- C4 Plani Strategjik i Zhvillimit 2012-2017.PDF
- C5 Rregullorja e Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.pdf
- C6 Statistikat e studentëve të diplomuar në Kolegjin Universitar "Wisdom".pdf
- C7 Plani Strategjik 2012 - 2017.PDF
- C8 Relacioni teknik i godinës.pdf
- C9 Studim tregu në psikologji .PDF

- C10 Axfenda me emrat përkatës për çdo mbledhje përkatëse pdf.pdf
C11 Dokumentet lidhur me heqjen e pezullimit dhe kriteret e përmbushura .pdf

Mbledhjet e organizuara gjatë vizitës

Mbledhjet referohen në raport me shkurtimet e mëposhtme:

Dita 1: E enjte 15 qershor 2017

- 08:45 - 09:00 **M1:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional.
- 09:00 - 09:30 **M2:** Mbledhje me Rektorin.
- 10:00 - 11:00 **M3:** Mbledhje me Grupin e Vetëvlerësimit.
- 11:30 - 12:30 **M4:** Mbledhje me të gjithë anëtarët e Senatit Akademik (pa përfshirë Rektorin).
- 13:30 - 14:30 **M5:** Mbledhje me të gjithë anëtarët e Rektoratit dhe Bordit (pa përfshirë personat, që janë takuar tashmë me Grupin e vlerësimit të Jashtëm)
- 15:00 - 16:00 **M6:** Mbledhje me një grup studentësh.
- 16:30 - 17:30 **M7:** Mbledhje me disa partnerë dhe alumni
- 18:00 - 18:15 **M8:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çfarëdolloj çështjeje që u ngrit gjatë Ditës 1.

Dita 2: E premte 16 qershor 2017

- 09:00 - 09:30 **M9:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çdo çështjeje të ngritur.
- 09:30 - 10:30 **M10:** Mbledhja me një grup të stafit mësimdhënës (pa përfshirë personat, që janë takuar tashmë me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm)
- 11:00 - 12:00 **M11:** Mbledhje me një grup të personelit administrativ (pa përfshirë personat, që janë takuar tashmë me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm)